



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNO SNAŽNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ / UROSEVAC

P.nr.560/2010

Më  
Dana

03.10.2016

NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari Adem Shabani, me asistentin Muedin Rexhepi në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga fsh. [REDACTED] komuna e Ferizajt, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.4 lidhur me par.1 nënpar.4 të KPK-së, sipas propozim akuzës së Prokurorisë Publike Komunale në Ferizaj PP.nr.936/2010 të dt.24.09.2010, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik me datën 30.09.2014 në prani të përfaqësuesit të akuzës-prokurorit të shtetit Ismet Rrahmani dhe të pandehurit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

I pandehuri [REDACTED] nga fsh. [REDACTED] komuna e Ferizajt, rr. [REDACTED] ndërtesa e [REDACTED] së, i lindur [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së varfër ekonomike, mbrohet në liri.

### Ë S H T Ë F A J T O R Ë

Sepse me dt.14.07.2010 rreth orës 07:00, në rrugën "[REDACTED]", në Ferizaj në banesën e të dëmtuarës, pas një mosmarrveshjeje me të dëmtuarën-[REDACTED] me të cilën jeton në bashkësi jashtëmartesore, e sulmon duke e goditur me grushta dhe shqelma në pjesë të ndryshme të trupit e cila pëson lëndime të lehta trupore- hematom në regjionin e kofshës së majtë dhe regjionin e nyjes së dorës së djathtë,-

me të cilën kreu veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par 4 lidhur me par 1 nën par 4 të KPK-së, hkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 lidhur me par.1 të KPK-së.

Në bazë të dispozitave të sipërcituara dhe nen.3, 34, 36, 39, 41, 42, 43, 44 dhe 64 të KPK-së dhe nen.365 të KPPK-së të pandehurit i shqipton :

### D Ë N I M M E K U S H T

Vërtetohet dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3/tre/ muaj, i cili nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën kohore prej 1/një/ viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

E dëmtuara [REDACTED] nga Ferizaji rr. [REDACTED], për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i pandehuri që në emër shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 25 € si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20€ në afat prej 15/pesëmbëdhjetë/ ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit.

## Arsyetim

PPK në Ferizaj me poropozim akuzë PP.nr.936/2010 të dt.24.09.2010 e ka ngarkuar të pandehurin [REDAKTUAR] nga fsh. [REDAKTUAR], komuna e Ferizajt tani me endbanim në Ferizaj, rr. [REDAKTUAR] ndërtesa e [REDAKTUAR], për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par 4 lidhur me par 1 nën par 4 të KPK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze mbajti shqyrtimin gjyqësor me dt. 0.09.2014 në të cilën përfaqësuesi i akuzës-prokurori i shtetit Ismet Rrahani mbeti në tërësi pranë propozim akuzës akuzës dhe kualifikimit juridik të veprave penale duke i propozuar gjykatës që i pandehuri të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet dënim i paraparë me ligj por me rastin e shqiptimit të saksionit penal gjykata të ketë për bazë pranimin e fajsisë.

I pandehuri, [REDAKTUAR] në shqyrtimin gjyqësor ka pranuar fajsinë për veprën e kryer, është penduar për atë që ka bërë ndaj [REDAKTUAR] me të cilën ka jetuar në bashkësi jashtëmartesore por që nga atëher më nuk ka patur problem me të dëmtuarën, ka premtuar se veprime të tilla nuk do të përsërius dhe ka kërkuar ti shqiptohet një denim sa më i butë pasi është i gjendjes së varfër ekonomike dhe nuk është duke punuar akund.

Gjykata konstatoi se janë plotësuar kriteret nga neni 326 par.4 të KPPK-së, shqyrtimi gjyqësor ka shkuar me fjalën përfundimtare të palëve pasi një pranim i tillë i fajësisë nga ana e të pandehurit mbështete në faktet e çështjes si dhe ne provat dhe materialet e prezentuara nga prokurori shtetit dhe ato që gjinden në shkresat e lëndës si mendimi dhe konstatimi i ekspertit të mjekësis ligjore i dt.19.09.2010 lidhur me lëndimet që ka pësuar e dëmtuara [REDAKTUAR].

Mbi bazën e pranimin të fajsisë nga ana e të pandehurit si dhe nga provat tjera te cilat gjenden ne shkresat e kesaj çështje penale gjykata gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: i pandehuri me dt.14.07.2010 rreth orës 07:00, në rrugën [REDAKTUAR], në Ferizaj në banesën e të dëmtuarës, pas një mosmarrveshtje me të dëmtuarën- [REDAKTUAR] me të cilën jeton në bashkësi jashtëmartesore, e sulmon duke e goditur me grushta dhe shqelma në pjesë të ndryshme të trupit e cila pëson lëndime të lehta trupore- hematom në regjionin e kofshës së majtë dhe regjionin e nyjes së dorës së djathtë.

Nga vlerësimi sipas aspektit juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit përfshihen të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par 4 lidhur me par 1 nën par 4 të KPK-së, për qka të njëjtin e ka shpallë fajtorë dhe I ka shqiptuar dënimin e kuishtëzuar dhe atë 3 muaj burg me kushtë që brenda periudhës prej 1 nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi I njëjti nuk do të kryej vepra penale.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nen. 64 të KPPK-së, duke i shqiptuar dënim si në dispozitiv - dënim me kusht pasi që ekzistojnë rrethana lehtësuese të cilat tregojnë se edhe dënimin me kusht te i pandehuri do të ndikoj pozitivisht dhe ai në të ardhmen nuk do të mere veprime të tilla, si rrethana veçanarisht lehtësuese gjykata pati parasysh faktin se i pandehuri është penduar për verën e kryer ku ka rrezikuar familjen e tijë por ishte moment që asë vet nuk ka mundur ta ketë nënë kontrollë eprimet e tija më parë nuk ka qenë i gjykuar, kjo është hera e parë që ndaj tij zhillohet procedurë penale, me bindjen se një dënim i tillë është plotësisht i justifikueshëm, adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me



peshën konkrete të veprave penale, shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe se me një dënim të tillë arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale në kuptim të nenit 34 të KPK-së .

Konform nenit 463 par 1 të KPPK-së e dëmtuara V [REDACTED] nga Ferizaji rr. [REDACTED], për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohet në kontest civil.

Gjykata duke u mbështetur në nen.450 par.2 pika 6 të KPPK-së ka obliguar të pandehurin që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 25 € si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 €.

Nga sa u theksua ma lart gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
P.nr.560/2010 të dt.30.09.2014

**Asistenti**  
Muedin Rexhepi

**Gjyqtari**  
Adem Shabani



**KËSHILLA JURIDIKE**

Kundër këtij aktgjykimi lejohet  
ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit,  
Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

*07.10.02.15*  
*Të akuzuarit*  
*etë nëpërmjet*  
*Të akuzuarit*